



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 5 Shkurt 2021

Nr: 31

VENDIM

**PËR SHOYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË BINDJA DEMOKRATIKE PËR
REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR NË ZGJEDHJET PËR KUVENDIN TË DATËS
25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 64 dhe 92/2 pika 2 të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi shqyrtova kërkesën e depozituar nga Partia Bindja Demokratike, për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin që do të zhvillohen në datën 25 Prill 2021,

V Ë R E J

Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92 shkronja “gj”, e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin.

Partia Bindja Demokratike, me shkronja nistore “BD”, nëpërmjet Kryetarit të saj, z. Astrit Patozi, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën dhe dokumentacionin përkatës për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin që do të zhvillohen më datë 25 Prill 2021, administruar me nr. 629 prot., datë 27.01.2021.

Kërkesa e paraqitur nga Partia Bindja Demokratike, respekton afatin kohor, të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni i paraqitur nga Partia Bindja Demokratike, për regjistrim si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e datës 25 Prill 2021, përbëhet si më poshtë:

- a) Vërtetimi lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 22.01.2021, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Partia Bindja Demokratike, me iniciale



Data: 5 Shkurt 2021

Nr. 31

Për shqyrtimin e kërkesës së Partisë Bindja Demokratike si subjekt zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin të datës 25 Prill 2021

“BD”, me Kryetar z. Astrit Patozi, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;

- b) emri, mbiemri dhe adresa e kryetarit të partisë;
- ç) emrin zyrtar, shkronjat nistore dhe adresa e partisë;
- d) specimeni i vulës së partisë;
- dh) emrin, mbiemrin dhe adresën e financierit të partisë (z. Elon Ciko);
- e) emrin, mbiemrin dhe adresën e personit përgjegjës për komunikimin me KQZ-në (z. Florjan Hajdini);
- ë) deklaratën me shkrim të nënshkruar nga kryetari i partisë politike ku përmendet angazhimi solemn për refuzimin për të marrë pjesë në praktika të blerjes së votës, marrjes së financimeve apo përfitimeve të kundërligjshme, veçanërisht nga ato që vijnë nga aktivitete kriminale, si dhe përkushtimin për të konkurruar në zgjedhje në mënyrë të ndershme dhe me integritet;
- f) deklaratën e partisë Model 01/1 për hapjen e llogarisë së posaçme nga kryetari i partisë.

Pas verifikimeve përkatëse konstatoj se, kërkesa dhe dokumentacioni i paraqitur nga Partia Bindja Demokratike, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64 dhe 92/2 pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, 64 dhe 92/2 pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar,

V E N D O S :

1. Të regjistrojë si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021 “Partia Bindja Demokratike”, me Kryetar z. Astrit Patozi, me shkronjat nistore “BD”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

